



SBASHK Arsimimi sot

Gusht, 2025

Gazeta elektronike

SBASHK-u i gatshëm për veprim në pritje të krijimit të institucioneve



Duke respektuar vendimin e Kongresit të Jashtëzakonshëm për angazhime, që me dialog me Qeverinë dhe MASHTI-n deri më 20 gusht të realizohen kërkesat legjitime të anëtarësisë, e nëse institucionet nuk tregojnë gatishmëri për dialog të bëhen përgatitje për veprime sindikale...(faqe 7)

SBASHK organizoi tri grupe të trajnimeve në Prishtinë



Rifillimin e punës pas pushimeve verore, SBASHK e nisi me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në dy programe të ndryshme të trajnimit, "Aplimimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie" ...(faqe 4)

Në pritje të konstituimit të Parlamentit dhe krijimit të institucioneve



Pushimet po ikin dhe po vjen 1 shtatori kur do të nis edhe një betejë për dije të reja...(faqe 2)

Podujeva arrin në rreth 1000 anëtarë në SBASHK, synon rritje edhe më të madhe



Kryetari i Sindikatës Komunale të Arsimit (SKAP) në Podujevë, Fadil Halimi, e ka marrë...(faqe 3)

SBASHK-u uron punëtorët arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor



SBASHK uron punëtorët arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor duke i përgëzuar që edhe në ditët e gushtit kanë qenë në institucione arsimore dhe kanë kryer e realizuar të gjitha përgatitjet për nismë të mbarë të ...(faqe 6)



Editorial

Në pritje të konstituimit të Parlamentit dhe krijimit të institucioneve



Pushimet po ikin dhe po vjen 1 shtatori, kur do të nisë edhe një betejë për dije të reja. Ky 1 shtator po vjen me shumë pikëpyetje e shqetësime. Tekstet shkollore duket se do të shpërndahen, përcjellur me shumë probleme e rreshta të gjatë para bankomatëve dhe librarive. Nga ana tjetër, kjo situatë pamundëson zhvillimin e dialogut për të kërkuar e realizuar kërkesat legjitime të anëtarësisë.

Këtë situatë e kanë analizuar Kryesia e SBASHK-ut, duke respektuar vendimet dhe afatet e Kongresit. Në komunikim me përfaqësuesit e punëtorëve të arsimit, që nga çerdhet e deri në universitete, kanë arritur në përfundim se në situatën aktuale nuk ka me kë të dialogojë SBASHK-u, sepse nuk kemi qeveri të dalë nga votat e 9 shkurtit. Prandaj, as edhe veprime sindikale, qoftë

protesta apo greva, nuk është situata të organizohen, sepse nuk kemi kujt t'i adresojmë kërkesat.

Pra, thënë më shkurt e më qartë: nuk kemi me kë të dialogojmë, e as nuk kemi kujt t'i bëjmë protestë e as grevë, sepse Kosova nuk ka institucione, e madje edhe Parlamenti nuk dihet kur do të konstituohet për të zhvilluar dialog me deputetët për vendimin e Kushtetueses lidhur me vlerën prej 0.5% për çdo vit të shërbimit. Jo siç e bëri Qeveria Kurti, si për inat, për 15 vitet e para jo 0.5%, por 0.25%, duke dëmtuar edhe në këtë mënyrë të punësuarit në arsim dhe në tërë sektorin publik.

SBASHK-u është i gatshëm për negociim të Kontratës Kolektive dhe për dialog për kushte më të mira të punës, për ngritje të vlerës së koeficientit të pagave dhe për gjithë kërkesat e anëtarësisë. SBASHK-u është i gatshëm edhe për veprime sindikale nëse nuk ka dialog dhe nëse kërkon anëtarësia e SBASHK-ut.

Në kuadër të këtij komunikimi, të punësuarve në arsim dhe gjithë nxënësve ua urojmë fillimin e vitit të ri shkollor, me lutjen që të formohen institucionet nga njerëz të duhur dhe që e vlerësojnë dialogun, në mënyrë që të mos ketë protesta e greva.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org


Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Podujeva arrin në rreth 1000 anëtarë në SBASHK, synon rritje edhe më të madhe



Kryetari i Sindikatës Komunale të Arsimit (SKAP) në Podujevë, Fadil Halimi, e ka marrë mandatin në krye të sindikatës komunale në këtë komunë për të tretën herë me radhë.

Si udhëheqës sindikal, Halimi ka thënë se është i kënaqur me arritjet e sindikatës komunale, ofrimin e shërbimeve për mësimdhënës, ndihmesën e tyre në rritje profesionale e përfitime të zbritjeve në shërbime të ndryshme.

Megjithatë, në një intervistë për gazetën mujore të SBASHK-ut, “Arsimimi sot”, kryetari i SKAP-it për Podujevë, Fadil Halimi, ka thënë se sindikata ka arritur ta rrisë edhe numrin e anëtarësisë, duke arritur në rreth një mijë anëtarë, derisa ka thënë se synon që ky numër të jetë edhe më i madh.

SBASHK: I nderuar prof. Fadil Halimi, e keni fituar mandatin e tretë nga zgjedhjet e rregullta të Sindikatës Komunale të Arsimit në Podujevë. Si po ndjeheni dhe çka do të thotë kjo për ju?

Halimi: Rizgjedhjen në krye të sindikatës komunale të arsimit në Podujevë për të tretën herë radhazi, në zgjedhjet e rregullta e demokratike që i kemi zhvilluar më 14 qershor të këtij viti, nuk e kuptoj si privilegj, por si përgjegjësi ndaj mësimdhënësve të shkollave, çerdheve e kopshteve të kësaj komune. Besimi dhe mbështetja e tyre më obligojnë edhe më shumë që të jem gjithnjë në shërbim të mësimdhënësve sindikalistë.

SBASHK: Cilat janë synimet tuaja për sindikatën gjatë këtij mandati?

Halimi: Sindikata komunale e Podujevës, sikur deri më tash, do të angazhohet që të jetë një zë i fuqishëm dhe

i vërtetë i kërkesave të punonjësve arsimorë. Përmes aktiviteteve të ndryshme jemi duke i afirmuar vlerat sindikale dhe duke i mbrojtur të drejtat e mësimdhënësve. Gjatë këtij mandati, synojmë t’i përfshijmë të gjithë punonjësit arsimorë në sindikatë, pasi kemi një unitet të plotë në të gjitha nivelet sindikale, nga çerdhet, shkollat fillore e të mesme.

SBASHK: E keni shtuar numrin e anëtarësisë në Podujevë gjatë këtij mandati. Sa është rritur ky numër dhe cilat janë pritjet tuaja?

Halimi: Në Komunën e Podujevës e kemi shtuar numrin e anëtarësisë dhe ky interesim e besim për ditë po rritet. Brenda një periudhe të shkurtër besoj që numri i anëtarëve do të rritet deri në 1000. Po ashtu, me të nisur viti i ri shkollor, anëtarët e rinj do të pajisen edhe me librezë të anëtarësisë. Me këto librezë ata mund të përfitojnë benefite nga organizata të ndryshme, me të cilat SBASHK-u ka marrëveshje bashkëpunimi.

SBASHK: Ku do të fokusoheni gjatë mandatit vijues në Podujevë? Çka synoni të përmirësoni për mësimdhënësit e Podujevës?


Halimi: Sindikata komunale një rëndësi të veçantë i ka kushtuar trajnimeve të mësimdhënësve, ku vetëm në 6-mujorin e parë të këtij viti janë certifikuar rreth 400 mësimdhënës në programet “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”. Duke u bazuar në kërkesat e shumta të mësimdhënësve, sindikata komunale do të organizojë edhe grupe të tjera trajnimesh nga këto programe. Sipas interesimit të madh të mësimdhënësve llapjanë për këto trajnime, SBASHK-u me prioritet po i trajton dhe po i mundëson ato, për çka mësimdhënësit shprehen falënderues.

SBASHK: Faleminderit për kohën dhe përgjigjet e detajuara. Akeni ndonjë mesazh për fundpërmësimdhënësit dhe anëtarët e Sindikatës në Podujevë?

Halimi: Po, dua të përfitoj nga kjo mundësi për të falënderuar të gjithë anëtarët e sindikatës për besimin dhe mbështetjen që më kanë dhënë tash e tri mandate me radhë. U siguroj se do të vazhdojmë me përkushtim dhe transparencë të plotë në mbrojtje të të drejtave të tyre dhe në avancimin e kushteve të punës. Bashkëpunimi i ndërsjellë dhe uniteti ynë do të jenë çelësi për arritjet e përbashkëta. I uroj një vit të mbarë shkollor të gjithë mësimdhënësve dhe suksese në misionin fisnik të edukimit të brezave.

Gjatë Muajit

SBASHK organizoi tri grupe të trajnimeve në Prishtinë



Rifillimin e punës pas pushimeve verore, SBASHK e nisi me organizimin e trajnimeve për mësimdhënës në dy programe të ndryshme: “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”.



Me kërkesë të mësimdhënësve të Prishtinës, me rikthimin e tyre nëpër shkolla, u mbajtën edhe tri grupe të ndryshme të trajnimit në shkollën “Dardania” në kryeqytet.



Një grup mësimdhënësish të kryeqytetit ndoqi trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie – moduli 1, me trajner Arben Zymeri. Grupi i dytë i mësimdhënësve ndoqi trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” – moduli 2, me trajnere Blerona Ahmeti, dhe grupi i tretë i mësimdhënësve vijoi trajnimin në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajner Afrim Gashi.



Me përfundimin e trajnimeve të grupeve nga programi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, moduli 1 dhe 2, SBASHK organizoi edhe testet gjatë javës së fundit të gushtit. Testet u administruan nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, dhe sekretari i përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri.



Në Gjiilan testi u Administrua nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri, derisa e pranishme ishte edhe trajnerja që e udhëhoqi këtë grup të mësimdhënësve, Ibadete Limani.



Kurse në Ferizaj, testet për dy grupe të mësimdhënësve u administruan nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe Zyrtares Ligjor, Blendor Shatri.




I pranishëm për të përcjellë nga afër mbarëvajtjen e trajnimit, por edhe testimit të mësimdhënësve, ishte edhe kryetari i SKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini.

Teste gjatë muajit gusht u mbajtën edhe në Ferizaj e Gjiilan për mësimdhënësit të cilët e kishin ndjekur me sukses trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”.

Mësimdhënës, prindër dhe ju nxënës urime viti i ri shkollor

SBASHK



SINDIKATA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS



E hëna e 1 shatorit shënoi fillimin e një beteje të re për dije. SBASHK-u ju drejtua punëtorëve arsimor, prindërve dhe nxënësve me urimin që ky vit shkollor të fillojë mbarë dhe të stoliset vazhdimisht me arritje e suksese të shumta.

Urojmë që të ndodh sa më shpejt furnizimi i nxënësve me tekste shkollore e të mos na përsëritet situata e dy viteve të kaluara shkollore kur me fajin e ministres Nagavci dhe MASHTI-t shkonte shatori pa u kompletuar të gjithë nxënësit me tekste dhe mjete mësimore.

Urojmë që sa më shpejt të kemi një Qeveri të Kosovës me njerëz që e ndejnë si nder dhe obligim të jenë anëtarë të kabinetit qeveritar e jo të ndjehen, si kjo Qeveria Kurti, se janë bërë shumë të mëdhenj dhe t'i shohin si armiq gjithë ata që guxojnë t'i kritikojnë kur punojnë keq apo nuk punojnë fare.

Mësimdhënës të nderuar duke ju uruar fillim të mbarë të vitit të ri shkollor ju falënderojmë për gjithë angazhimet në vitet e shkuara dhe ju lusim që të vazhdoni me misionin tuaj të shenjtë për edukimin dhe arsimimin e brezave.

Prindër të nderuar edhe juve ua urojmë fillimin e vitit të ri shkollor duke ju lutur që të jeni pranë mësimdhënësve e t'i ndihmoni në realizimin e qëllimit të përbashkët për arritje e suksese sa më të larta. Ju lusim që mos të ngiteni kundër mësuesit, për t'i hyrë në hatër pushtetit, as atëherë kur punëtorët e arsimit janë në protestë apo në grevë. Të jeni të bindur ata nuk i duan këto veprime sindikale, por i bëjnë pas pritjes së gjatë që qeveritarët të bisedojnë me SBASHK-un dhe të ofrojnë zgjidhje për kërkesat legjitime. Prindër të nderuar fëmijët tuaj nuk kalojnë as edhe një minutë me qeveritarët po kalojnë një pjesë të madhe të ditës me mësimdhënësit.

Nxënës të nderuar duke ua uruar edhe juve fillimin e vitit të ri shkollor ju ftojme të angazhoheni sinqerisht për të fituar njohuri të reja dhe të dëgjoni këshillat e mësuesit dhe prindit. Janë këta që ua duan sinqerisht të mirën dhe luten që ju të arrini sa më shumë në jetë.

Rrahman Jasharaj,
SBASHK



SBASHK-u i gatshëm për veprim në pritje të krijimit të institucioneve



Duke respektuar vendimin e Kongresit të Jashtëzakonshëm për angazhime që me dialog me Qeverinë dhe MASHTI-n të realizohen kërkesat legjitime të anëtarësisë deri më 20 gusht, e nëse institucionet

nuk tregojnë gatishmëri për dialog të bëhen përgatitje për veprime sindikale. Kryesia e SBASHK-ut mbajti takim më 20 gusht dhe në konsultim edhe me shumë prej kryetarëve të nivelit komunal e të universiteteve, analizoi situatën aktuale duke shprehur shqetësim për moskrijimin e institucioneve me të cilat do të zhvilloheshin takime dhe do të provohej fillimisht që me dialog të zgjidheshin kërkesat legjitime të anëtarësisë. Në rast se vullneti i institucioneve për dialog do të mungonte, atëherë do të ndërmerren veprime sindikale pa përjashtuar as grevën e përgjithshme. Duke parë se ende nuk kemi institucione me të cilat do të dialogonim apo ndaj të cilave do të drejtoheshin veprimet sindikale, SBASHK-u deklaroi se është i gatshëm për veprime qoftë për takime e dialog qoftë për veprime sindikale e greva dhe kështu do të veprojë duke respektuar zërin e anëtarësisë me krijimin e institucioneve të shtetit tonë.

SBASHK-u përkrahu protestën e OVL të UÇK-së në sheshin “Skenderbeu”, për drejtësi ndaj krerëve të UÇK-së në Hagë: Zëri ynë i bashkohet zërit të së vërtetës dhe drejtësisë!

Anëtarët e SBASHK-ut, nga çerdhet e deri në universitete, sipas bindjeve vullnetare, ishin pjesë e protestës madhështore paqësore të thirrur nga organizatat e dala nga lufta e lavdishme e UÇK-së.

Më 7 gusht, ora 17, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, përfaqësuesit e SBASHK-ut në mënyrë të organizuar ishin pjesë e protestës, duke bërë që të dëgjohet zëri ynë i fuqishëm, në përkrahje të bijve më të mirë të kombit, që padrejtësisht po mbahen prapa grilave në Hagë.

Pjesëmarrja e gjerë e punëtorëve të arsimit, shkencës dhe kulturës në këtë protestë ishte një mesazh i qartë: ne nuk e harrojmë sakrificën!

Falë atyre që sot padrejtësisht ndodhen në qeli, ne sot gëzojmë lirinë, ecim të lirë në shtetin tonë dhe edukojmë brezat për atdhedashuri e drejtësi. SBASHK-u ngre zërin për drejtësinë, për lirinë dhe për ata që sakrifkuan gjithçka për të ardhmen tonë.

